

QKPA

RAPORTI VJETOR

2019

Qendra Kombëtare e Pritjes së Azilkërkuesve



HYRJE

Në kuadër të transparencës dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore për llogaridhënie, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, përmes një analize të detajuar, paraqet këtë raport të fokusuar mbi punën dhe aktivitetin institucional gjatë vitit 2019. Kjo përmbledhje, shfaq jo vetëm objektivat dhe rezultatet e arritura, por gjithashtu nxjerr në pah problematikën me të cilën Qendra është ndeshur gjatë vitit raportues.

Viti 2019 ka qenë në fakt tejet i rëndësishëm dhe sfidues për Qendrën pasi krahasuar me vitet e mëparshme shënoi një numër të lartë azilkërkuesish të akomoduar. Ata kanë qenë me shtetësi të ndryshme, kryesisht nga Siria, Iraku, Afganistani, Maroku, Irani, etj. Prioritet i punës sonë ka qenë dhe mbetet mbarëvajtja dhe organizimi i pritjes së tyre, akomodimi dhe ofrimi i shërbimeve të domosdoshme, duke sjellë një angazhim më të madh në menaxhimin e situatave të ndryshme të krijuara për shkak të këtij fluksi azilkërkuesish.

Puna e QKPA gjatë vitit 2019 ka pasur si lajtmotiv jo vetëm përmirësimin e standardeve të shërbimeve të ofruara e sigurinë e azilkërkuesve/refugjatëve, por edhe ofrimin e asistencës shëndetësore, psiko-sociale, linguistike dhe ligjore. Ndër objektivat e Qendrës ka qenë edhe administrimi me efektivitet i fondeve buxhetore dhe burimeve financiare duke ndjekur zbatimin e planifikimit të fondeve buxhetore miratuar për vitin 2019 dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërveprimi me të gjitha strukturat që operojnë në fushën e migracionit dhe azilit.

QKPA, jo vetëm gjatë vitit raportues por edhe në vazhdim, zotohet të angazhohet në zgjidhjen e sfidave të ardhshme, duke u udhëhequr nga përgjegjshmëria, integriteti dhe transparenca për të punuar me përkushtim e seriozitet drejt cilësisë së shërbimeve e përmbushjes së standardeve më të larta sa i takon shërbimeve të ofruara për azilkërkuesit/refugjat.

Drejtores,

Anila Agalliu

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| Përmbajtja | |
| HYRJE | II |
| REALIZIMIET..... | 1 |
| STATUSI JURIDIK I QKPA-së DHE STRUKTURA..... | 3 |
| • Struktura e QKPA-së dhe organigrama..... | 3 |
| SEKTORI I MBËSHTETJES SË AZILKËRKUESVE..... | 4 |
| • Bashkëpunimi me struktura të Policisë së shtetit..... | 7 |
| • Njohja e azilkërkuesve me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat e azilit..... | 8 |
| • Aktivitete të realizuara..... | 9 |
| SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE..... | 9 |
| • Realizimi i zërave të buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2019 të procedurave të prokurimit..... | 12 |
| • Proceset gjyqësore..... | 12 |
| • Rekrutimi i personelit..... | 12 |
| • Trajnimet..... | 12 |
| PROBLEMATIKAT E HASURA GJATË VITIT 2019..... | 13 |
| ARRITJE..... | 14 |
| PRIORITET/OBJEKTIVAT DHE MASAT ME RËNDËSI NË AKTIVITETIN E QKPA-së PËR VITIN 2020..... | 15 |

REALIZIMET

Gjatë vitit 2019, Qendra Kombëtare për Azilkërkuesit ka punuar me impenjimin dhe profesionalizmin e duhur për realizimin e detyrave dhe objektivave sipas përgjegjësive që përcaktohen në aktet ligjore dhe ato normative që rregullojnë funksionimin e institucionit.

Në kuadër të objektivave dhe prioriteteve të institucionit për vitin 2019, më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur veprimtaria për këtë periudhë:

1. QKPA ka përgatitur draft – rregulloren e brendshme të funksionimit të saj, paraqitur për vlerësim në Drejtorinë Juridike dhe Standardizimit në MB;
2. Gjithashtu, në mungesë të rregullores së brendshme, janë përgatitur akte të brendshme të funksionimit të institucionit, si:
 - 2.1 Përshkrimi i vendit të punës për çdo funksion organik të institucionit, sipas formatit paraprak të dakortësuar në draft-rregullore;
 - 2.2 Janë përgatitur procedurat standarde të punës.
3. Është bërë analiza dhe programimi për rialokimin e fondeve sipas nevojave emergjente të institucionit dhe ndryshimi në Regjistrin e Planifikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2019. Rialokimi i fondeve të shpenzimeve për ushqimet.
4. Është hartuar Projekt-buxheti Afatmesëm për vitet 2020-2022 (faza I dhe II), ku janë bashkëngjitur kërkesat shtesë:
 1. Ndryshimin e organikës së QKPA-së.
 2. Shpenzime operative (për artikuj ushqimor)
 3. Invenstimi për mure rrethues.
 4. Blerje materiale për akomodimin e azilkërkuesve.
5. Janë hartuar e miratuar programe pune, raporte mujore dhe raporte të tjera periodike, të cilat pasqyrojnë objektivat kryesore, punën e kryer në përmbushje të tyre, burimet dhe kapacitetet e angazhuara dhe tregues të tjerë për institucionin.
6. Është plotësuar e përditësuar dosja personale për çdo punonjës, me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor e administrativ. Përditësohen periodikisht Regjistri i Punëmarrësit dhe ndiqet dinamika e pasurimit të dosjeve me vlerësime periodike,

praktika disiplinore, vjetërsi në punë e procedura të tjera që shoqërojnë punonjësin gjatë veprimtarisë së punës.

7. Është ndërtuar një procedurë e rregullt administrative e ligjore, sa i përket emërimeve të punonjësve të rinj, praktikave disiplinore dhe atyre të lirimit nga detyra. Për çdo rast, plotësohet sipas standardeve dokumentacioni i duhur dhe ndiqen etapat përkatëse sipas e në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. U skanuan gjithë dokumentet e dosjeve personale të punonjësve dhe u ngarkuan në sistemin HRMIS. Ky sistem është plotësuar në çdo rubrikë, në vazhdimësi janë bërë përditësimet e duhura sipas dinamikës së lëvizjeve të personelit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga punonjësit.
9. Është rikonceptuar Kontrata e Punës, sipas ndryshimeve të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës dhe akteve të tjera normative.

I. STATUSI JURIDIK I QKPA-së DHE STRUKTURA

Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit është institucion ku akomodohen dhe trajtohen persona të huaj me apo pa shtetësi që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri në respektim të legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus ato të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Funksionon në varësi të Ministrisë së Brendshme nga viti 2004, me VKM Nr. 262, datë 23.04.2004 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik, si dhe për organizimin e funksionimin e saj dhe për shtesë në numrin e parashikuar të punonjësve të kësaj ministrie”.

Aktualisht Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit funksionon sipas strukturës së miratuar më Urdhër të Kryeministrit Nr. 79, datë 21.02.2014 dhe VKM-së Nr. 332, datë 04.05.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues”.

Struktura e QKPA-së dhe organigrama


Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit është e organizuar në dy sektorë me përbërje prej 15 punonjës:

- 1- Titullari i Institucionit.
- 2- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse me 11 punonjës.
- 3- Sektori i Mbështetjes së Azilkërkuesve me 3 punonjës.

SEKTORI I MBËSHTETJES SË AZILKËRKUESVE


Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit është institucion ku akomodohen dhe trajtohen persona të huaj me apo pa shtetësi që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Nisur nga situata aktuale e numrit të azilkërkuesve të akomoduar gjatë këtij viti në QKPA, prioritet i punës sonë ka qënë organizimi dhe menaxhimi i pritjes, akomodimit dhe ofrimit të shërbimeve të domosdoshme për azilkërkuesit, krahas shërbimeve shëndetësore, ligjore dhe të drejten e arsimit.

ORGANIGRAMA E QENDRËS KOMBËTARE PRITËSE PËR AZILKËRKUES



Gjatë vitit 2019, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues ka pritur dhe akomoduar në total 6700 azilkërkues sipas statistikave të mëposhtme :

- 5098 të rritur, ku nga këto 829 janë femra dhe 4269 meshkuj; 1602 të mitur, përkatësisht 532 vajza dhe 1070 djem.
- 1478 janë minoren të shoqëruar dhe 124 janë minoren të pashoqëruar




| Viti | 0 -18vjeç | | Mbi 18 vjeç (të rritur) | | Totali |
|-----------|-----------|---------|-------------------------|---------|--------|
| | Femra | Meshkuj | Femra | Meshkuj | |
| Viti 2019 | 532 | 1070 | 829 | 4269 | 6700 |
| Viti 2018 | 159 | 310 | 246 | 3656 | 4371 |
| Viti 2017 | 16 | 41 | 21 | 230 | 308 |

Për sa i përket numrit të minorenëve të pashoqëruar, të akomoduar gjatë vitit 2019, është më i lartë se gjatë vitit 2018 dhe 2017. Gjatë vitit 2019 raportohen 124 minoren të pashoqëruar të akomoduar

| Viti | Minoren | |
|-----------|--------------|----------------|
| | Të shoqëruar | Të pashoqëruar |
| Viti 2019 | 1478 | 124 |
| Viti 2018 | 452 | 17 |
| Viti 2017 | 57 | 0 |

në Qendër. Pjesa më e madhe e tyre janë me origjinë nga Siria, konkretisht 38 persona; 8 persona janë me origjinë nga

Pakistan, 9 persona janë me origjinë nga Palestina, 15 me origjinë nga Iraku, 9 me origjinë nga Maroku, 5 me origjinë nga Algjeria 11 me origjinë nga Egjipti, 3 me origjinë nga Libia, 2 me origjinë nga Sudani, 1 person me origjinë nga Jemeni dhe Somalia, 21 persona me origjinë nga Afganistani dhe 1 me origjinë nga Irani.





Grafiku tregon personat e akomoduar gjatë vitit 2019

| NR. | SHTETËSIA | FAMILJE | PERSONA | MESHKUJ | FEMRA |
|---------------|-----------|----------|----------|----------|----------|
| 1 | Kosovarë | 1 | 5 | 4 | 1 |
| 2 | Bullgarë | | 1 | 1 | |
| TOTALI | | 1 | 6 | 5 | 1 |

Grafiku tregon personat e akomoduar gjatë vitit 2018.


Sipas një krahasimi të bërë për 2017-ën, 2018-ën, 2019-ën, vihet re se gjatë dy viteve të fundit numri i azilkërkuesve të akomoduar është më i lartë se viti 2017. Koncretisht numri i azilkërkuesve të akomoduar në vitin 2019 është shumë më i lartë në krahasim me vitin 2018 me

diferencë 2329 ose +150% ; krahasuar me 2017-ën me diferencë 6392.



- Në 6 mujorin e parë të vitit 2019 kemi pasur 11 persona me statusin e refugjatit. Aktualisht kemi 6 persona; 5 prej tyre janë me origjinë nga Kosova dhe vetëm 1 prej tyre është me origjinë nga Bullgaria.


Gjatë vitit 2019 janë akomoduar një numër i madh familjesh me shtetësi të ndryshme, konkretisht 765. Nga grafiku vihet re se 58% e familjeve janë me shtetësi nga Iraku, 31% me shtetësi nga Siria dhe pjesa tjetër janë me origjinë nga Afganistani, Maroku, Palestinë, Iran.



Në krahasim me vitin 2019, gjatë vitit 2018 janë akomoduar një numër më i vogël familjesh, konkretisht 230, ku pjesa më e madhe e familjeve janë nga Siria 68 % prej tyre dhe 23% janë me origjinë nga Iraku.

Disa prej familjeve të akomoduar, me kërkesën e tyre janë zhvendosur jashtë Qendrës me mbështetjen e UNHCR-së dhe RMSA-së. Konkretisht, gjatë këtij viti në total janë zhvendosur 24 (njëzet e katër) persona.

Tabela e mëposhtme paraqet një pamje më të qartë.



- Gjatë vitit 2018 është riatdhesuar 1 person me origjinë nga Irani, ndërsa gjatë vitit 2019 është riatdhesuar një person me origjinë nga Maroku.

| NR. | SHTETËSIA | FAMILJE | PERSONA | MESHKUJ | FEMRA |
|---------------|-----------|----------|-----------|-----------|----------|
| 1 | Irak | 1 | 9 | 6 | 3 |
| 2 | Siri | 1 | 8 | 6 | 2 |
| 3 | Kosovë | 1 | 5 | 3 | 2 |
| 4 | Palestinë | 1 | 2 | 1 | 1 |
| TOTALI | | 4 | 24 | 16 | 8 |

- Gjatë vitit 2019 numri i personave të rikthyer nga DVKM të ndryshëm është 1048.

Një ndër shërbimet që ofrohet në këtë institucion është ai psikologjik, ku zhvillohen takime dhe terapi individuale me azilkërkuesit që ndodhen në Qendër, terapi me fëmijët , terapi në grup dhe vlerësime psikologjike. Psikologia ka bërë vlerësime psikologjike dhe psikosociale, ku gjatë vitit 2019 janë realizuar 80 vlerësime për azilkërkuesit. Me qëllim shuarjen e konflikteve, menaxhimin e situatës janë zhvilluar takime në grup me synim njohjen dhe afrimitetin e azilkërkuesve me njëri-tjetrin , shkëmbimin e kulturave të ndryshme dhe krijimin e një marrëdhëni sa më të mirë midis tyre.

Për të krijuar një mjedis sa më argëtues dhe relaksues për fëmijët, në Qendër ndodhet një dhomë posaçërisht për ta e quajtur “Dhoma e fëmijëve”. Punonjësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve disa here në javë bëjnë të mundur shoqërimin e fëmijëve, duke krijuar lojëra argëtuese dhe zhvilluese për ta. Përpos dhomës së fëmijëve, Qendra ofron gjithashtu edhe sallën e internetit, ku azilkërkuesit mund të aksesojnë në internet dhe të komunikojnë me familjarët e tyre.

Bashkëpunimi me struktura të Policisë së Shtetit

- Bashkëpunimi me strukturat e Policisë ka qënë i vazhdueshem dhe shumë efikas.
- Gjatë vitit 2019, ky bashkëpunim ka qënë shumë i domosdoshëm për shkak të situatës dhe trajtimit të rasteve problematike.
- Kemi patur raste të dhunës dhe konflikteve ndërmjet azilkërkuesve për të cilat ka qënë e nevojshme ndërhyrja dhe prania e strukturës së policisë së shtetit (Komisariati i Policisë nr. 5).

- Bashkëpunimi me DVKM-të ndryshme për azilkërkuesit që kanë hyrë në teritorin e Republikës së Shqipërisë, deri në akomodimin në QKPA.
- Me Komisaratin nr.5, kemi qënë në kontakte të vazhdueshme për shqetësimet dhe problemet tona si dhe prezantimi i rasteve dhe largimet nga Qendra të azilkërkuesve.
- Kemi patur bashkëpunime edhe me struktura të antiterrorit dhe ShISH për raste të veçanta.
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë në Ministri, për problemet e statusit të azilkërkuesve.
- Bashkia Kamëz është një tjetër institucion me të cilën QKPA-ja ka bashkëpunim. Gjatë vitit 2019-të, në Bashkinë Kamëz janë raportuar 124 (njëqind e njëzet e katër) minorenë të pashoqëruar, ku më pas këto të fundit vazhdojnë procedurat për t'u ardhur në ndihmë këtij target grupi.

Ndër organizatat me të cilat bashkëpunon Qendra janë; UNHCR, RMSA, Caritas Albania. RMSA ka mundësuar shërbimin me dy kujdestarë nate dhe një infermiere. Kujdestarët e natës u vinë në ndihmë azilkërkuesve, duke bërë të mundur shoqërimin e tyre në spital në orët e vona të natës. Konkretisht gjatë vitit 2019 këtë shërbim e kanë marrë shumë azilkërkues. Infermierja ka ofruar shërbimin e parë dhe ka asistuar në shoqërimin e tyre në qendra të ndryshme spitalore.

Njohja e azilkërkuesve me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat e azilit

Në momentin e akomodimit azilkërkuesit njihen me rregullat e brendshme të kësaj Qendre si dhe të drejtat dhe detyrimet që ata kanë. Më pas u lind e drejta për të marrë informacion mbi vazhdimësinë e procedurave për azil, njëkohësisht u shpërndahet një fletëpalosje në gjuhën angleze, arabe, farsi dhe pashtu.

Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë është shprehur për 10 azilkërkues me “Pushimin e procedurës së shqyrtimit për aplikimin për azil”, 5 azilkërkues me “Njohjen e statusit të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë” dhe 10 azilkërkues me “Vërtetim të dorëzimit të aplikimit për azil”.

| Viti | Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë | | |
|------|---|---|---|
| | “Pushimin e Procedurës së Shqyrtimit për Aplikimin për Azil | Njohjen e Statusit Të Mbrojtjes Plotësuese në Republikën e Shqipërisë | Vërtetim të Dorëzimit të Aplikimit për Azil |
| 2019 | 10 | 5 | 10 |

Aktivite të realizuara

Gjatë vitit 2019 organizata të ndryshme kanë bashkëpunuar me Qendrën në ditë festash për t’ju sjellë azilkërkuesve dhe refugjatëve një ditë ndryshe.

- Gjatë muajit Mars, me datë 26.03.2019 Caritas Albania në kuadër të fushatës “Share the Journey” të lançuar nga Papa Francesku, në bashkëpunim me QKPA, organizoi një aktivitet me natyrë edukative dhe argëtuese. Ky organizim përfshiu të gjithë azilkërkuesit dhe refugjatët që ndodhen brenda Qendrës. Gjatë këtij aktiviteti u organizua një catering dhe u shpërndanë lodra të ndryshme për fëmijët.
- Gjatë muajit Prill, me datë 23.04.2019 Caritas Albania në kuadër të festave të “Pashkëve”, në bashkëpunim me qendën organizoi një aktivitet me natyrë argëtuese. Gjatë këtij aktiviteti u organizua një catering. Caritas Albania në bashkëpunim me punojësit e Qendrës krijuan një mjedis argëtues për azilkërkuesit dhe refugjatët.
- Në Maj dhe në Qershor të 2019 Komuniteti Mysliman, me rastin e muajit të Ramazanit, në bashkëpunim me stafin e Qendës organizoi një darkë iftari.
- Në 20 Qershor “Dita Botërore e Refugjatëve” Qendra në bashkëpunim me “Tirana Art” organizoi një aktivitet me natyrë argëtuese, duke krijuar një atmosferë të gëzueshme për fëmijët dhe të rriturit.
- Gjatë muajve Korrik-Gusht në QKPA janë zhvilluar disa intervista me azilkërkuesit në zbatim të projektit For Work.

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE


Hartimi, planifikimi, menaxhimi eficientë dhe efektiv i buxhetit për plotësimin e nevojave të azilkërkuesve merr një rëndësi të veçantë për institucionin tonë.


Përsa i përket zbatimit të buxhetit, fondi i akorduar në fillim të vitit 2019, në nivel artikulli për njësinë shpenzuese QKPA, është në total 37.075.000 lekë. Kjo vlerë është e detajuar sipas zërave të shpenzimeve të strukturës buxhetore e paraqitur dhe në tabelën e realizimit të mëposhtëm.

Shpenzime nga buxheti i shtetit për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019 janë sipas pasqyrës së mëposhtme:

| Nr | Art | Emërtimi | Plani | Plani me ndryshime | Realizimi | Diferenca | % Realizimi |
|----|-----|---|--------|--------------------|-----------|-----------|-------------|
| 1 | 600 | Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli | 10.200 | 0 | 9.354 | 846 | 92 |
| 2 | 601 | Kontribute për sig. shoqërore dhe shëndetësore | 1.700 | 0 | 1.546 | 154 | 91 |
| 3 | 602 | Mallra e shërbime | 19.555 | 14.708 | 33.875 | 389 | 99 |
| 4 | 606 | Transferta për buxhetet familjare dhe individët | 5.620 | 0 | 5.620 | 0 | 100 |
| 5 | 231 | Investime | | 242 | 242 | 0 | 100 |
| 6 | 466 | 5% Garanci punimesh | | 3.707 | 3.707 | 0 | 100 |
| | | TOTALI | 37.075 | 18.658 | 54.344 | 1.389 | 98 |

Bazuar në VKM Nr. 581, datë 10.08.2011 “Për dhënie ndihme financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit Nr. 33, datë 24.02.2012 “Për dhënie ndihmë financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë”, në buxhetin e QKPA-së është parashikuar në shumën prej 5.620.000 për të mbuluar dhënie ndihmës financiare për gjashtë familje për pagesën e qirasë së banesës, të ushqimit, energjisë elektrike dhe të ujit dhe është realizuar në masën 91%.





Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 janë bërë ndryshime (shtesa) fondesh në krahasim me akordimin fillestar të buxhetit. Këto ndryshime janë bërë në artikullin 602 “Mallra e shërbime, në vlerë totale 14.408.800 lekë për plotësimin e nevojave të lindura në zërin e ushqimeve si rezultat i shtimit të numrit të azilkërkuesve. Shtesat e fondeve janë bërë me kërkesë të QKPA-së dhe të miratuara nga Ministria e Brendshme.

Gjithashtu nga Ministria e Brendshme është bërë shtim fondi në artikullin 231 “Rritje e AQT” në shumën 241.560 lekë.

Është bërë rakordimi i fondeve dhe me ndryshimet që kanë pësuar zërat gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019 me degën e thesarit, duke pasqyruar transaksionet e kryera deri në nivel nënartikulli sipas strukturës dhe klasifikimit buxhetor.

Ndjekja, realizimi dhe raportimi i buxhetit është bërë nëpërmjet evidencave progresive të realizimit të buxhetit ku për çdo muaj raportohet në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Realizimi i zërave të buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2019 të procedurave të prokurimit:

| Nr | Objektii Prokurimit | Planifimi i Vitit 2019 | Realizimi i Vitit 2019 | Kurrsimi në % | Organi i financimit |
|----|--------------------------|------------------------|------------------------|---------------|---------------------|
| 1 | Dezinfektimi i ambientit | 300000 | 118860 | 39.62 | Buxheti i Shtetit |
| 2 | Gaz i lengshem | 500000 | 320000 | 64 | Buxheti i Shtetit |
| 3 | Ilace mjekesore | 150000 | 148000 | 98.6 | Buxheti i Shtetit |
| 4 | Kancelari | 170000 | 106000 | 62.3 | Buxheti i Shtetit |

| | | | | | |
|---|--|---------|------------|------|-------------------|
| 5 | Materiale Pastrimi Detergjent | 800000 | 338000 | 42.2 | Buxheti i Shtetit |
| 6 | Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres | 170000 | 97500 | 57.3 | Buxheti i Shtetit |
| 7 | Sherbime per mirembajtjen e automjeteve te transportit | 300000 | 264900 | 88.3 | Buxheti i Shtetit |
| 8 | Sherbimi i ruajtjes fizike | 1191676 | 1191674.16 | 99.9 | Buxheti i Shtetit |
| 9 | Uniforma dhe veshje | 800000 | 449990 | 56.2 | Buxheti i Shtetit |

✚ Proceset gjyqësore ku QKPA është palë e paditur.

Gjatë vitit 2019, 4 (katër) punonjës kanë paditur QKPA-në me objekt dëmshpërblim page.

✚ Rekrutimi i personelit

Struktura e QKPA-së përbëhet nga 15 punonjës, të cilët trajtohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2019 janë paraqitur tre dorëheqje të punonjësve dhe është marrë masë disiplinore largim nga puna për një punonjëse. Është proceduar për plotësimin e vendeve vakante.

✚ Trajnimet

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit , të aftësive menaxhuese dhe funksionale të punonjësve në funksion të procesit të standardizimit të kujdesit dhe shërbimeve të ofruara, u mundësua pjesëmarrja e punonjësve në disa trajnime të organizuara nga organizata të ndryshme dhe ASPA.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 5 trajnime;

- 6-8 Shkurt Caritas – Albania realizoi trajnimin me temë “Identifikimi i personave vulnerable në grupet miks migratore”
- 24-25 Prill IOM realizoi trajnimin me temë; “Lufta kundër kontrabandimit të migrantëve përgjatë rrugës bregdetare të Ballkanit Perëndimor”
- 10-13 Qershor “Ligji i Prokurimit Publik”
- 19 Qershor “Trajnim për sistemin HRMIS”
- 18-20 Shtator “Prokurimi publik niveli i avancuar”

✚ PROBLEMATIKAT E HASURA NE PUNËN E QKPA-SË, GJATË VITIT 2019

- Mungesa e specialistëve të fushës brenda QKPA-së për hartimin e standardeve, përshkrimin e specifikimeve teknike të disa objekteve të prokurimit (mallra), sjellë si domosdoshmëri bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme ose me institucione të varësisë.
- Duke qenë se ofrohet shërbim 24/7 orë edhe gjatë fundjavës përfshirë edhe ditët e festave zyrtare dhe referuar numrit të pamjaftueshëm të punonjësve në strukturën e QKPA-së, hasim vështirësi në përfitimin e ditëve të pushimit sipas Kodit të Punës nga ana e specialistëve të sektorit të mbështetjes së azilkërkuesve.
- Mungesa e mjekut dhe infermierit në strukturën e QKPA-së, për t’u asistuar në qendër dhe për të dhënë ndihmën e parë azilkërkuesve, duke i shoqëruar dhe transportuar në çdo kohë pranë qendrave shëndetësore dhe spitalore, përkthyer në kosto në transport, në kohë dhe në punonjës, pasi në shoqërimin e të sëmurit në urgjencë, në spital apo në qendrën shëndetësore në lagje, punonjësit i duhet të shkëputet nga problemet e shumta të cilat ndërkohë duhet t’i ndjekë në Qendër.
- Mungesa e stafit (kujdestar nate) ka sjellë shqetësime për akomodimet e azilkërkuesve në Qendër në orët e vona të natës, të shoqëruar nga DVKM-të.
- Mirëmbajtësi është i domosdoshëm për faktin e riparimeve dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe materialeve të ndryshme në ambientet e akomodimit dhe ambientet e tjera ndihmëse.
- Kemi hasur vështirësi në akomodimin e të miturve të pashoqëruar për të cilët duhet të trajtohen nga strukturat përkatëse. Me miratimin e ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përgjegjësia për strehimin dhe mbështetjen psikosociale dhe ligjore për fëmijët e pashoqëruar u kalon strukturave të ngritura në bazë të këtij ligji për të miturit. Njësitë pranë çdo bashkie duhet të trajtojnë çdo rast të të miturit të pashoqëruar.
- Trajnimi i personelit përgjegjës për prokurimin, financën në lidhje me azhornimet e legjislacionit në bashkëpunim me APP-në dhe ASPA-n.
- **Fluksi i lartë i azilkërkuesve solli vështirësi në ofrimin e shërbimit të ushqimit gjate viti 2019. Nisur nga tendenca në rritje e fluksit të lartë të azilkërkuesve, krahasuar me vitin 2019, shprehim shqetësimin se buxheti i vitit 2020 nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e shërbimeve.**
- Me urdhrin nr. 363, dt.12.04.2019 të Ministrit të Brendshëm është miratuar regjistri elektronik (Data Base) të dhënat e të cilit funksionojnë në mënyrë integrale midis tri strukturave: Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, Departamentit të Kufirit dhe Migracionit dhe QKPA-së.

Gjatë përdorimit të regjistrit elektronik (Data base) shpeshherë janë hasur mosrakordime shifrash të cilat vijnë për shkak të moshedhjes së të dhënave nga përdoruesit e tjerë.

- Për godinën e ndërtuar nga donatori UNHCR, me fonde të Bashkimit European, në territorin e QKPA-së, është mundësuar vënia në dispozicion e dokumentacionit nga ana e Ministrisë. Jemi në pritje të plotësimit të grupit të punës për marrjen në dorëzim të saj.

✚ ARRITJE

- Shërbimet ndaj fluksit të lartë të azilkërkuesve janë mirëmenaxhuar edhe pse shpeshherë jemi hasur me problematika të ndryshme, duke përfshirë edhe situata konfliktuale midis tyre.
- Pajisjen me Certifikatën e Pronësisë mbi objektet mbi të cilat ushtron veprimtarinë e saj QKPA.
- Në bashkëpunim me IKMT-në dhe strukturat përkatëse u arrit lirimi i ambienteve të zaptuara të cilat i përkasin QKPA-së.
- Në bashkëpunim me RMSA-në u arrit të sigurohet shërbimi i infiermerisë dhe 2 kujdestarëve të natës.

✚ PRIORITETET/OBJEKTIVA DHE MASAT ME RËNDËSI NË AKTIVITETIN E QKPA-SË PËR VITIN 2020 JANË SI MËPOSHTË:

1. Ristrukturimi dhe organizimi i QKPA-së në funksion të objektivave, përmirësimin e standardeve, për një shërbim sa më efikas ndaj azilkërkuesve dhe refugjatëve në bashkëpunim me strukturat përkatëse në Ministrinë e Brendshme dhe DAP, i parashikuar edhe në kërkesën tonë në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022.
2. Përmirësimi i standardeve të shërbimeve të ofruara për azilkërkuesit/refugjatët në QKPA:
3. Administrimi me efektivitet i fondeve buxhetore dhe burimeve financiare:
4. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional.
5. Përmirësimi i akteve normative për funksionimin e institucionit.
 - Rishikimi dhe miratimi i Rregullores së Brendshme të QKPA-së me miratimin e ligjit të ri “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.
6. Ngritja e kapaciteteve të stafit të qendrës nëpërmjet planifikimit dhe organizimit të trajnimeve të stafit.

7. Planifikimi i projektit për ndërtimin e murit rrethues për sigurinë e jetës së azilkërkuesve që stresohen në ambientet e QKPA-së, ruajtja e ambienteve të akomodimit si dhe zyrave të administratës, pasi ndodhemi në zonën e Babrrusë dhe direkt në rrugë pa asnjë rrethim nga pjesa e përparme, në pjesën e prapme të godinave ekziston një mur, i cili është pjesërisht i amortizuar dhe nuk ka lartësinë e duhur për mos lejimin e kapërcimit të tij nga individë. Pranë me objektet e QKPA-së janë ngritur banesa private, shqetësimi i krijuar nga azilkërkuesit është i përbashkët për ne si institucion, por edhe për banorët e zonës. Planifikim ky i parashikuar edhe në kërkesën tone në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022.

FALEMINDERIT!